



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 05.03.2020, 30.03.2020, 06.04.2020, 16.04.2020 dhe 22.04.2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
- 6. Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 05.03.2020, 30.03.2020, 06.04.2020, 16.04.2020 dhe 22.04.2020.

Mbledhja plenare e datës 15 maj 2020 çelet me prezantimin e pikave të rendit të ditës (lexohet rendi).

Pas prezantimit të rendit të ditës, zonja Brunilda Kadi merr fjalën për të propozuar një pikë shtesë të fundit në rendin e ditës në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të mbledhjeve plenare për sa i përket mënyrës se si zhvillohen online apo në sallën plenare dhe le të diskutohet nga kolegët për t’u diskutuar në mbledhjen plenare ose jashtë mbledhjes plenare, por duhet të diskutohet si do vijohet më tutje për mënyrën e organizimit të mbledhjeve. Propozimi i saj edhe një herë është që të bëhet në mbledhje diskutimi dhe nëse votohet nga shumica, të diskutohet si pikë e fundit.

Zoti Qoku është i mendimit që sot mbledhja është me 9 pika dhe nëse do shtohet edhe një pikë tjetër, i bie që të zgjatet shumë. *Zoti Qoku* është i mendimit që ky diskutim të lihet për të hënë apo më tutje.

Zonja Kadi rimerr fjalën duke u shprehur se nuk kushton gjë nëse do diskutohet 10 minuta. Megjithatë, të votohet dhe mos të futet në rendin e ditës.

Zonja Llagami rikujton procedurën që duhen 6 anëtarë për të futur në rendin e ditës një çështje për diskutim. Nëse 6 nga anëtarët duan ta përfshijnë në rendin e ditës, le të shprehin dakordësinë.

Zoti Toska merr fjalën i cili shpreh që, kjo çështje të diskutohet bashkërisht qoftë edhe në verandën e Këshillit (meqë është ambienti më i madh), por mos të diskutohet në mbledhjen plenare online dhe të zgjidhet se si do të procedohet.

Zonja Kadi rimerr fjalën dhe shprehet se mendimet e anëtarëve duhet të regjistrohen dhe të protokollohen diku, pasi nuk mund të flitet në ajër, por bëhet fjalë për përgjegjshmëri.

Zoti Toska përgjigjet se mund të bëhen me e-mail dhe të lihet gjurmë. Pra i sugjeron zonjës Kadi që të bëjë një material dhe anëtarët të rrotullohen rreth asaj që duhet të diskutohet.

Zonja Kadi shprehet se ka disa diskutime për të bërë përderisa e propozon si pikë të rendit të ditës dhe një nga pikat e diskutimit ka qenë pikërisht që janë ngritur nga zonja Kadi këtë shqetësim edhe me shkrim, por nuk i është kthyer përgjigje, e-mail i dërguar kryetares dhe që e kanë edhe anëtarët e tjerë. Në datën 15 prill kur filloi të bëhej kjo mënyrë e organizimit të mbledhjes ku disa rrinë në sallë dhe disa rrinë ku të duan (është online) dhe para disa ditësh kur u diskutua në lidhje me përgjigjen që iu dha institucionit të Presidentit të Republikës, i është kërkuar kryetares që si është vendosur që nuk bëhen mbledhjet plenare sepse zonja Kadi mendon që është kompetencë e Këshillit që ta vendosë këtë gjë. Të gjitha këto që u thanë deri tani, mund të diskutoheshin në qoftë se do ishte përfshirë në rendin e ditës. Megjithatë le të votojnë anëtarët, -shton zonja Kadi.

Hidhet në votim propozimi i bërë nga zonja Kadi dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është kundër dhe shton se të gjithë janë të shqetësuar për ecurinë dhe mënyrën se si do kalohet nga kjo situatë; të gjithë janë të shqetësuar për transparencën dhe për pjesën tjetër që të ulen anëtarët në seancat plenare, por duke pasur parasysh disa kufizime që janë vënë për këtë shkak, nga akti normativ, për shkak të COVID, Këshilli duhet të jetë shumë i qartë në atë që bën. Zoti Hallunaj është shumë dakord që të fillohet me seancat plenare në sallë të gjithë, por pasi të hiqet ajo pjesa e barrierave, nëse lejohet apo jo. Prandaj zoti Hallunaj është kundër vetëm për procedurë.

Zonja Kadi ndërhyt më tej për të thënë edhe ajo mendimin e saj.

Ndërkohë ndërhyt edhe **zonja Llagami** e cila i drejtohet zonjës Kadi që, kur anëtarët janë në votim mos të ndërpriten, pasi është bërë rregull që ndërpritet votimi nga zonja Kadi.

Rimerr fjalën **zonja Kadi** duke u shprehur se zoti Hallunaj sapo e bëri këtë prishje të rregullit, pasi dha mendimin e tij. Ato që u thanë nga zoti Hallunaj gjatë votimit, mund të thuheshin kur të bëhej pjesë e rendit të ditës kjo dhe të diskutoheshin të gjitha, çfarë thotë akti dhe çfarë thotë protokollin. Të gjitha këto do mund të thuheshin kur kjo çështje të futej në rendin e ditës. Zonja Kadi vijon të shprehet se siç e tha edhe zoti Hallunaj mendimin e tij edhe zonja Kadi dha mendimin e saj, pasi herën e kaluar është “qortuar” zonja Kadi nga zoti Hallunaj sa i përket faktit që sa herë janë në votim hidhet diskutim sepse ngatërrohen gjërat. Prandaj kërkon që të mbahet një standard.

Dhe **zonja Llagami** në përgjigje thekson se standardi është mbajtur dhe është ai i vendosur nga zonja Kadi, pasi zonja Kadi flet, voton dhe pastaj përsëri flet. Ndaj zonja Llagami kërkon që kur anëtarët kanë hyrë në procedurë votimi, të lërë mundësi anëtarëve të votojnë dhe pasi të mbarojë procedura të bëhen sqarimet.

Zonja Kadi sërish kërkon që të zbatohet ligji dhe standardet të jenë të njëjta për të

gjithë anëtarët.

Zonja Llagami thekson se ligji zbatohet shumë mirë dhe standardet ruhen shumë mirë.

(Vijon procedura e votimit.)

Ilir Toska është kundër.

Alban Toro është dakord, të përfshihet.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord për të diskutuar se cilat janë masat që duhen marrë për të konkluduar lidhur me vijimin e mbledhjeve në sallë apo jo.

Erjon Muharremaj është kundër, me arsyetimin e zotit Hallunaj.

Brikena Ukperaj është dakord që të diskutohet në mbledhjen plenare e më pas për të dhënë mendimin kur të futet në rendin e ditës.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord që të futet në mbledhjen plenare.

Me shumicë votash miratohet propozimi i zonjës Kadi për të shtuar në rendin e ditës diskutimin në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të mbledhjeve plenare për sa i përket mënyrës se si zhvillohen ato.

Fillon çështja e parë e rendit të ditës.

Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 05.03.2020, 30.03.2020, 06.04.2020, 16.04.2020 dhe 22.04.2020.

Hidhen në votim nga Kryetarja e Këshillit dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord, përveç procesverbalit të datës 16 prill 2020 duke menduar që ka shumë shkurtime të ekzagjeruara të fjalëve të anëtarëve dhe kërkon që të rishikohet edhe një herë që të pasqyrohen më të plota fjalët. Zonja Kadi nuk është kundër përmbajtjes por mendon që duhet të jetë më e pasqyruar dhe jo aq i shkurtuar.

Në sqarim, për sa i përket procesverbaleve, zonja Llagami sqaron që në zbatim të ligjit procesverbalet bëhen të përmbledhura, për sa kohë audio hidhet e plotë online pas mbarimit të mbledhjes. Mund të ketë diskutime lidhur me saktësinë apo pasaktësinë e përmbledhjeve, por fjala nuk mund të jetë e plotë, për sa kohë është online e mundësuar për të gjithë fjala e plotë në audio.

Zonja Kadi rimerr fjalën sërish për të rikujtuar ligjin dhe procedurën e për të shprehur se nuk mund të komentohet votimi i saj, pasi ky ishte qëndrimi i saj.

Zonja Kadi rithekson edhe një herë që procesverbali i datës 16 prill të ribëhet duke përfshirë më shumë përmbajtje të tij sepse është shumë i shkurtuar.

Dritan Hallunaj është dakord.

Gjatë votimit, kërkon fjalën zonja Ukperaj e cila i referohet nenit 69, pika 5 të ligjit nr.115/2016 çdo anëtar duhet të kërkojë me anë të një kërkesë me shkrim korrigjimin, duke qenë e përcaktuar saktë ku është përmbledhja e paqartë dhe çfarë duhet të shtohet.

Zonja Kadi ndërhyt për të thënë se ky ishte mendimi i saj dhe se nuk mund të ta mësojë njeri se si të flasë. Kërkon sërish që të respektohet ligji.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro gjithashtu është i mendimit që procesverbali i datës 16 vërtetë duhet i përmbledhur, por jo telegrafik. Për sa i përket fjalëve të zotit Toro në këtë procesverbal, shumë fjalë kanë humbur dhe është lënë vetëm një fjalë teke, e cila nuk e sintetizon atë çka ka dashur të përcjellë tek anëtarët por edhe tek publiku. Edhe zoti Toro kërkon që të rishikohet ky procesverbal.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord, përveç procesverbalit të datës 16, për të cilin

propozon që të shtyhet votimi lidhur me miratimin e këtij procesverbalit për t'u riparë edhe një herë nga administrata lidhur me transkriptimin e tij. Pra është dakord, përveç procesverbalit të datës 16.

Erjon Muharremaj është dakord, me arsyetimin që, sa kohë, në funksion të transparencës, të gjitha procesverbalet ndodhen të plota në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të nuk ka asnjë problem tjetër.

Brikena Ukperaj është dakord, me arsyetimin që secili nga anëtarët që ka pasaktësi ose ka pretendime lidhur me korrigjimin apo mospasqyrimin saktë të përmbledhjes së procesverbalit, duhet të bëjë një kërkesë me shkrim dhe pastaj e vendos mbledhja, sepse secili mund të ketë kontestime për mënyrën sesi pasqyrohet procesverbalit i përmbledhur sepse është hera e parë që procesverbalet mbahen në mënyrë të përmbledhur.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord, duke rikujtuar që neni 69 i jep mundësinë që çdo anëtar të bëjë komente paraprakisht lidhur me përmbledhjen e procesverbalit, përpara se të miratohet në mbledhje plenare. Ligji shprehet për draft-procesverbal. Procesverbalet janë nisur në drejtim të anëtarëve më datë 30 prill dhe nga ana e anëtarëve nuk është bërë asnjë koment deri më sot lidhur me pasaktësitë në procesverbal (ku nuk diskutohet mënyra e përmbledhjes), pasaktësi e cila duhet të verifikohet me audion. Nga zonja Llagami kërkohet që nëse ndonjë anëtar ka diskutime lidhur me pasaktësi në procesverbal, duhet t'ia parashtrorj në administratës përpara se sa çështja të kalojë në mbledhje plenare. Për sa kohë nga ana e anëtarëve nuk është parashtruar kjo gjë, mendon që procesverbalet do kalojnë në votim dhe u miratuan tashmë nga shumica.

Merr fjalën **zonja Kadi** e cila shprehet se procesverbalet nuk vijnë tufë nga 10 procesverbale, për t'u parë dhe për t'u miratuar dhe citon nenin 69 i cili shpreh se procesverbalit (dhe këtu zonja Kadi e thekson fjalën "procesverbalit") dërgohet minimumi 7 ditë përpara dhe miratohet në mbledhjen e radhës, si dhe shton në fjalën e saj se legjislatori nuk e ka vënë kot këtë, e ka vënë që edhe mos të harrohet, pasi nuk mund të kontrollohen 10 procesverbale njëherësh. Procesverbalet vazhdojnë të mos hidhen audio,

në kundërshtim me ligjin, ku janë hedhur vetëm një pjesë e tyre në faqe duke nxjerrë kështu të pavërtetë deklarin që zonja Llagami ka bërë në mbledhjen e datës 16, ku është thënë që janë hedhur të gjitha audiot. Ndaj zonja Kadi sugjeron që të bëhen deklarime të vërteta.

Në përgjigje të zonjës Kadi, merr fjalën sërish **zonja Llagami** e cila i referohet sërish nenit 69/5, ku legjislatori përmend fjalën “procesverbalet” në shumës, pra e lejon që të dërgohen më shumë se një procesverbal. Janë dërguar nga administrata para dy javësh 5 procesverbale. Ligji thotë që procesverbalet me draftin e përmbledhjes së diskutimeve nënshkruhen dhe vihen në dispozicion.

Në vijim, **zonja Kadi** sqaron se shumësi i përdorur për procesverbalet nga legjislatori në ligj i referohet seancës plenare e cila mund të ketë disa procesverbale dhe sërish citon pikën 3 të nenit 69 e cila thotë që procesverbali miratohet seancën pasardhëse të mbledhjes plenare dhe fton zonjën Llagami të lexojë pikën 3 të nenit 69.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi me shumicë votash:

“1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 05.03.2020, 30.03.2020, 06.04.2020, 16.04.2020 dhe 22.04.2020.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për zgjatjen e mandatit të Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, ngritur me Vendimin e KLGJ-së nr. 317, datë 19.12.2019, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
6. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit për zgjatjen e mandatit të Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, ngritur me Vendimin e KLGJ-së nr. 317, datë 19.12.2019, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Medi Bici.

Merr fjalën zoti Medi Bici i cili lexon relacionin shpjegues lidhur me projektvendimin “Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, për monitorimin dhe zbatimin e memorandumit të mirëkuptimit”.

Ndër të tjera në relacion parashtrohet e gjithë veprimtaria e këtij Komisioni që nga ngritja e deri më sot, duke filluar me vendimin nr. 317, datë 19.12.2019, ku Këshilli ka vendosur ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e një Planit Veprimesh

Lidhur me Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura dhe Rritjen e Efikasitetit në Gjykatën e Lartë, ndërsa me datë 30.03.2020 Këshilli ka miratuar Memorandumin e Mirëkuptimit, prioritetet kryesore të të cilit janë: trajtimi nëpërmjet veprimeve të menjëhershme, të stokut të çështjeve të prapambetura, parandalimi në të ardhmen i krijimit të një shtate të tillë dhe ndërgjegjësimi i publikut për veprimtarinë e ngushtë të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, me vendimin nr. 147, datë 28.04.2020 Këshilli ka vendosur ndryshimin në Memorandum sa i përket palëve nënshkruese ku dhe Memorandumi është nënshkruar më datë 29.04.2020 dhe pritet të vazhdojë për një periudhë prej 10 muaj nga data e nënshkrimit të tij dhe mund të zgjatet me shkrim, me pëlqimin e palëve.

Bazuar në këtë Memorandum Mirëkuptimi, Këshilli ka marrë përsipër të zgjasë me afat të pacaktuar, mandatin e Komisionit të Përkohshëm, i cili i dedikohet mbikëqyrjes së nismës për efikasitetin e gjykatës dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në GJL, të përshkruar në këtë memorandum, me qëllim që të mbulojë zbatimin e plotë të nismës.

Në përmbushje të angazhimeve të marra përsipër nga ana e Këshillit, sipas Memorandumit të Mirëkuptimi, nga ana e tij duhet të procedohet me zgjatjen e afatit të veprimtarisë së këtij Komisionit të Përkohshëm, i cili do të ketë si objekt të vetëm të veprimtarisë së tij, monitorimin dhe zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, të nënshkruar me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Për sa i përket afatit propozohet që të jetë një afat i pacaktuar, apo për aq kohë sa do jetë në fuqi ky memorandum.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Merr fjalën *zonja Llagami* e cila fton anëtarët nëse kanë diskutime mbi çështjen duke shtuar në fjalën e saj se nga ana e EURALIUS-it është kërkuar që pjesë e diskutimeve të Komisionit të Përkohshëm në vijim të zgjatjes së mandatit, të jenë edhe rishikimi i procedurave, siç e relatoi z. Bici. Nëse vlerësohet që brenda qëllimit dhe objektivave që ka ky Komision të përfshihet, nuk ka nevojë për ndryshime, atëherë është okej për zonjën Llagami, nëse jo dhe duhet që të shprehet shprehimisht në një pikë, është në vlerësim të anëtarëve.

Duke qenë se ky është një diskutim që nuk është bërë në Komision, por objekti i këtij Komisioni e përfshinte këtë, -shton zonja **Brunilda Kadi**, pasi Komisioni është për marrjen e një sërë masash dhe Memorandumi ishte një prej masave. Këtij Komisioni i mbaroi afati më datë 31 mars ose ka edhe atë diskutimin tjetër të pezullimit. Zonja Kadi është e mendimit që ndoshta propozimi të lihet të diskutohet në një moment tjetër dhe të mendohet më qetë se si duhet të jetë propozimi ku thjesht të shtohet ndoshta në objekt ose të shikohet si interpretim në objektin që ka pasur më përpara dhe prandaj propozon që të ecet kështu siç është dhe më pas të shikohet nëse ka vend për ndryshime në një moment, në mbledhjen e radhës.

Zonja Ukperaj merr fjalën më pas e cila shton se zgjatja e afatit të Komisionit, nënkupton që nuk është vetëm për monitorimin apo mbikëqyrjen e zbatimit të Memorandumit por zgjatja është edhe për hartimin e planeve të tjera të masave, pasi mund të ndodhë që gjatë veprimtarisë së këtij Komisioni dhe të Gjykatës së Lartë, mund të dalin alternativa të ndryshme që mund të çojnë në reduktimin e masave. Pra duke zgjatur afatin e Komisionit sipas veprimtarisë që ka pasur, duke i shtuar edhe monitorimin e zbatimit të Memorandumit, çështja e propozimeve për ndryshimet ligjore është e përfshirë, sipas zonjës Ukperaj, duke vijuar më tej që të bëhet një saktësim në pikën 2 të Memorandumit ku termat “monitorim” dhe “zbatim” të zëvendësohen me “mbikëqyrje të zbatimit të Memorandumit”, pasi angazhimi i Këshillit është të mbikëqyrë zbatimin e Memorandumit. Pra mbikëqyrja tregon hierarkinë e Këshillit përkundrejt Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht përputhet edhe me termat e përdorur në Memorandum.

Sipas **zonjës Kadi**, terminologjia e përdorur në Memorandum është e saktë sa i përket termave të përdorur “monitorimi dhe zbatimi” dhe propozon që të shtohet në pikën 2 edhe lidhëza “edhe” përpara fjalëve “monitorimi dhe zbatimi”, që do të thotë që pika 1 është vazhdimi i asaj që ka pasur në fillim, ku përfshihet në objekt edhe të gjithë masat e tjera, dhe në mënyrë të posaçme, në pikën 2, duke përdorur lidhëzën “edhe”, do të thotë

që po shtohet edhe kjo kompetencë që në fakt buron si detyrim për Këshillin nga teksti i Memorandumit.

Ndërkohë **zonja Llagami** kujton që në tekstin e Memorandumit është përdorur termi “mbikëqyrje”, duke pranuar gjithashtu propozimin e bërë nga zonja Kadi për të shtuar lidhëzën “edhe” në pikën e dytë.

I të njëjtit mendim është edhe **zoti Bici**, por që të dali i qartë, pasi diskutimi është bërë që në mbledhjen e parë nga znj. Kadi, tek afati, pasi nëse do dalë ndonjë pasaktësi edhe tek rishikimi i legjislacionit, duhet të mblidhen sërish. Këtë kërkon që të jetë e saktë zoti Bici dhe është dakord me termin që përdor znj. Ukperaj, pasi ai term përshtatet me termin e përdorur në Memorandum, duke qenë gjithashtu edhe pro propozimit të bërë nga zonja Kadi.

Ndërsa **zonja Kadi** e rithekson që termi i saktë duhet të jetë “monitorim dhe zbatim”, pasi “zbatimi” është më angazhues sesa fjala “mbikëqyrje”, pra zonja Kadi e rithekson që është kundër propozimit që bëri zonja Ukperaj për termin “mbikëqyrje”. Sugjeron që të dy propozimet të hidhen në votim të ndara nga njëra-tjetra, pra në fillim që të shtohet lidhëza “edhe”, që në fund tregon që këtij Komisioni i shtohet edhe kjo kompetencë. Ndërsa ajo që shpreh zonja Ukperaj është tjetër gjë.

Gjithashtu edhe **zonja Marçela Shehu** është dakord me propozimin e bërë nga zonja Kadi për të shtuar lidhëzën “edhe” tek objekti i veprimtarisë së Komisionit, ndërsa lidhur me termat “monitorim”, “zbatim” dhe “mbikëqyrje” sugjeron që termi “monitorim” të zëvendësohet nga termi “mbikëqyrje” dhe termi “zbatim” të mbetet, kjo pasi Komisioni duhet të jetë përgjegjës jo vetëm për zbatimin por edhe për mbikëqyrjen e këtij zbatimi. Ndërsa nëse thuhet vetëm “mbikëqyrje”, del që Komisioni zhvishet nga kompetencat e zbatimit që faktikisht i takojnë sipas Memorandumit.

Këtij sugjerimi i bashkohet edhe **zonja Kadi**, e cila rithekson që termi “zbatim”

duhet të qëndrojnë dhe ndërkojnë pra është dakord me propozimin e zonjës Shehu, që të vendoset termi “mbikëqyrje” bashkë me termin “zbatim”.

Edhe **zonja Ukperaj** është dakord me përdorimin e termave “mbikëqyrje” dhe “zbatim”, pasi është në mënyrë ezauresuese angazhimi që është marrë në Memorandum për t’ia kaluar Komisionit, ndërsa për sa i përket propozimit për të shtuar lidhëzën “edhe”, gjithashtu është pjesë ezauresuese duke i thënë që i japin Komisionit edhe këtë kompetencë, kompetenca e mëparshme për hartimin e planit të masave vazhdon të qëndrojë dhe mund të përfshijë edhe pjesën e iniciativës ligjore, prandaj është e mendimit që nuk është e nevojshme që të shkohet në një vendimmarrje tjetër apo të saktësohet pjesa e iniciativës ligjore, si një objekt i veçantë i këtij Komisioni.

Ndaj shton **zonja Kadi** që nëse nuk vendoset lidhëza “edhe” mund të konfundohet pasi duket pika 2 sikur ai është objekti i këtij Komisioni. Prandaj rithekson sërish se nuk është keq të vendoset lidhëza “edhe”, përkundrazi bëhet edhe më e qartë që këtij Komisioni po i shtohet edhe kjo kompetencë.

Ideja e zotit Bici ishte që ky Komision të kishte edhe angazhimin për të ngritur iniciativa për ndryshime legjislative, - shton **zonja Ukperaj**.

Këtë gjë e thotë pika 1 sepse i zgjat mandatin siç e kishte në fillim Komisioni, ndërsa pika 2 ka për qëllim që t’i japë një kompetencë që nuk e ka pasur në fillim, -shton **zonja Kadi**.

Zonja Shehu merr fjalën në vijim për të formuluar propozimin e pikës 2: “2.Objekt i veprimtarisë së këtij Komisioni të Përkohshëm do të jetë edhe mbikëqyrja dhe zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit, i nënshkruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.”

Hidhet në votim propozimi për ndryshim në pikën 2 të projekt-aktit, sipas tekstit të lexuar nga zonja Shehu, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.
Brunilda Kadi është dakord.
Dritan Hallunaj është dakord.
Iilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë vendosi: 1. Zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e një Plani Veprimesh, lidhur me Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura dhe Rritjen e Efikasitetit në Gjykatën e Lartë (Komisioni), i ngritur me vendimin nr.317, datë 19.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Objekt i veprimtarisë së këtij Komisioni të Përkohshëm do të jetë edhe mbikëqyrja dhe zbatimi i Memorandimit të Mirëkuptimit, i nënshkruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.

3. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Komisionit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, do të jetë pa afat, deri në përmbushjen e plotë të angazhimeve të marra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për aq kohë sa do të jetë në fuqi ky Memorandum Mirëkuptimi.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Përkohshëm.

5. Në përmbushjen e detyrave të tij, Komisioni do të mbështetet nga personeli administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriteve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
6. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Maksim Qoku.

Merr fjalën zoti Qoku i cili lexon relacionin shpjegues të projektvendimit “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”.

Ndër të tjera, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë që do të pranohen për të ndjekur për

një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, në respektim të procedurës së përcaktuar në ligj, ka kryer verifikimin e plotësimit të kriterëve, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga çdo kandidat.

Nga lista përfundimtare që ka përcjellë Shkolla e Magjistraturës 51 kandidatë kanë shprehur vullnetin për të qenë kandidatë për Këshilltarë dhe 80 kandidatë për Ndhmës Ligjorë. Pas verifikimit të dosjeve të secilit kandidat ka rezultuar se nga 51 kandidatë për Këshilltarë, vetëm 24 prej tyre plotësojnë kriteret, ndërsa 27 prej tyre nuk i plotësojnë kriteret, pasi të 27 kandidatët kanë pasur përvojë profesionale më pak se 10 vjet. Gjithashtu pas verifikimit të dosjeve të secilit kandidat ka rezultuar se nga 80 kandidatë për Ndhmës Ligjorë, 72 prej tyre plotësojnë kriteret, ndërsa 8 prej tyre nuk i plotësojnë kriteret, pasi nuk kanë pasur përvojë profesionale 5 vjet (7 prej tyre dhe 1 nuk i janë provuar vitet e përvojës profesionale, për shkak të natyrës së punës që ka kryer).

Në relacion sqarohet se: Gjatë vlerësimit të bërë mbi dosjen e çdo kandidati, Komisioni i Përkohshëm, ka marrë në konsideratë dhe disa rrethana për shkak të situatës së krijuar nga fatkeqësia natyrore. Për dokumente të cilat në dosje kanë qenë fotokopje, është komunikuar në formë telefonike me Shkollën e Magjistraturës dhe është vërtetuar se një pjesë e aplikantëve kanë depozituar aplikimin e tyre dhe për magistrat, për këtë arsye ka ndodhur që në dosjen për këshilltarë dhe ndihmës ligjore të jenë depozituar kopje e dokumenteve jo të noterizuara, por pamundësia për t'i kërkuar kandidatëve të depozitojnë dokumente të noterizuara për shkak të situatës, ka qenë jo e mundur, për këtë arsye këto dokumente janë marrë të mirë qenë. Gjithashtu për aplikuesit që janë kualifikuar për të kaluar në fazën e testimit për pozicionin Këshilltar edhe pse nuk kanë pasur të depozituar dokumente që provojnë autorësinë e artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës, Komisioni ka vlerësuar të mbajë të njëjtin qëndrim dhe t'i kualifikojë këta kandidatë, siç ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme dhe Komisioni i mëparshëm i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, për vitin akademik 2019-2020, pra që t'i kualifikojë.

Projektvendimit janë bashkëlidhur të katër listat me kandidatë:

1. Lista e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit

për Ndhmës Ligjorë; 2. Lista e kandidatëve që nuk kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit për Ndhmës Ligjorë; 3. Lista e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit për Këshilltarë Ligjorë; 4. Lista e kandidatëve që nuk kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit për Këshilltarë Ligjorë.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Përkohshëm mbi projektvendimin “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër pasi nuk plotësojnë kriteret ligjore.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021, për Këshilltarë Ligjorë, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 - 2021, për Ndhmës Ligjorë, sipas Lidhjes 2,

bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
6. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ndër të tjera, në relacion parashtrohet se pas përfundimit të afatit për kandidimin në pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 89, datë 26.02.2020 më datë 06.05.2020, rezulton se kanë kandiduar 3 kandidatë ku njëri prej tyre e ka paraqitur kandidimin dy ditë përtej afatit ligjor. Ndërsa dy kandidatet e tjera të cilat kanë aplikuar brenda afatit të

kandidimit, janë në proces e sipër të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 88, datë 26.02.2020, sipas vendimit nr. 152, datë 06.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Gjithashtu zoti Toska parashton edhe lidhur me strukturën e projektvendimit, i cili përbëhet nga tre pika. Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat kanë aplikuar edhe për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit janë në proces e sipër për këto kandidime dhe si rrjedhojë janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 89, datë 26.02.2020. Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet mospërfshirja në listën e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të znj. {...}, për shkak të aplikimit mbas përfundimit të afatit të kandidimit për këtë pozicion të lirë.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.
Dritan Hallunaj është dakord.
Ilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat kanë aplikuar edhe për pozicionin e shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 89, datë 26.02.2020.

3. Mospërfshirjen në listën e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të znj. {...}, për shkak të aplikimit mbas përfundimit të afatit të kandidimit për këtë pozicion të lirë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i çështjes lidhur me caktimin e komisionit që do të përgatisë komentet për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
6. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i çështjes lidhur me caktimin e komisionit që do të përgatisë komentet për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021.

Çështje e diskutuar në mbledhjen e datës 30.03.2020.

Zonja Llagami sqaron se çështja ka qenë e shtruar për diskutim në mbledhjen e datës 30.03.2020 sa i përket shkresës së dërguar nga Shkolla e Magjistraturës më datë 12 mars e cila bënte fjalë për kandidatët e profilit magjistrat që kanë aplikuar për pranimin në Formimin Fillestar për vitin akademik 2020-2021, për të cilët Këshilli duhet të japë komente dhe sugjerime lidhur me listat e kandidatëve që kanë plotësuar dhe që nuk kanë plotësuar kriteret ligjore. Në këtë mbledhje diskutimi u shty dhe për këtë shkak është futur të diskutohet kush do të jetë Komisioni për shqyrtimin dhe dhënien e komenteve dhe sugjerimeve lidhur me plotësimin apo jo të kriterëve ligjore të kandidatëve për magjistratë.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Zonja **Marçela Shehu** merr fjalën dhe propozon, duke u nisur edhe nga praktika e vjetshme ku opinioni për kandidatët për në Shkollën e Magjistraturës ashtu edhe relacioni për verifikimin e kriterëve ligjore për ndihmësit dhe këshilltarët, u bë nga i njëjti Komision, që opinioni të përgatitet nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë, i ngritur me vendimin e Këshillit nr. 66, datë 06.02.2020, por duke konsideruar shtimin e fushës së veprimtarisë (objektit) të këtij Komisioni.

Anëtarët e Këshillit bien dakord që ashtu si edhe vitin e kaluar edhe këtë vit, i njëjti Komision që kryen verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë, të përgatisë edhe opinionin me komentet lidhur me listat e kandidatëve të profilit magistrat që kanë aplikuar për pranimin në Formimin Fillestar për vitin akademik 2020-2021.

Në mbledhjen e radhës lihet që Komisioni i Përkohshëm të vijë me një propozim konkret në lidhje me ndryshimin e vendimit, sa i përket fushës së veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm, duke qenë se në ligj nuk është e qartë se në kompetencën e cilit Komision është dhënia e këtij opinioni.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
- 6. Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Alban Toro.

Merr fjalën zoti Alban Toro i cili relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Në relacion parashtrohet se gjyqtari në fjalë ka filluar karrierën e gjyqtarit me vendim të ish-Këshillit në vitin 2000 dhe aktualisht është gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Gjyqtari i është drejtuar KLGJ-së me një kërkesë në maj të vitit 2020 me anë të së cilës kërkon mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, duke u bazuar në nenin 65/1 të ligjit nr.96/2016: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës..”.

Gjithashtu zoti Toro parashtron se dorëheqja është një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë dhe prevalon mbi çdo akt dhe veprim tjetër administrativ mjafton që organi që e merr në shqyrtim të qartësohet për shprehjen e vullnetit.

Aktualisht ka një shkresë të gjyqtarit i cili kërkon dorëheqjen dhe në këto kushte Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit:

- Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për këtë gjyqtar, në datë 30.06.2020, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit si dhe të përjashtojë gjyqtarin nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në datë 30.06.2020, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit.

2.Të përjashtojë gjyqtarin z.{...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

3.Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...}, sipas kërkesave të

shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi opinionin për kandidaten znj. {...} në procedurën e komandimit si pedagoge e brendshme, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

9. Erjon Muharremaj (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

Shënim: Nuk merr pjesë në shqyrtimin e kësaj pike, zoti Maksim Qoku.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjqësor.

2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjqësor.

3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.

5. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.

6. Përfaqësues të Misionit EURALIUS.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi opinionin për kandidaten znj. {...} në procedurën e komandimit si pedagoge e brendshme, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zonja Llagami sqaron fillimisht se anëtari z. Maksim Qoku ka kërkuar të mos marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje, kërkesë e pranuar nga ana e Kryetares së Këshillit. Nuk merr pjesë në shqyrtimin e kësaj pike zoti Maksim Qoku.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Marçela Shehu.

Merr fjalën zonja Marçela Shehu e cila lexon opinionin mbi kandidatin që ka aplikuar për t’u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës.

Ndër të tjera, zonja Shehu parashtron se Këshilli i Lartë Gjqësor, me vendimin nr. 99 datë 26.02.2020, shpalli hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës

së Magjistraturës, ndërsa afati i fundit për paraqitjen e kërkesave ishte deri më 29.04.2020. Brenda këtij afati ka paraqitur kërkesë gjyqtarja zonja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më tej, zonja Shehu shton se në respektim të dispozitës ligjore të nenit 54 të ligjit për Statusin, ku Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë (në këtë rast) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin (...) dhe; vendimit nr. 99 datë 26.02.2020 të Këshillit, ku brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin (...), Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka çmuar se, në rastin konkret, komandimi i kësaj gjyqtareje nuk vjen ndesh me interesat e larta të gjykatës ku ajo ushtron funksionin, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykata më e madhe në vend nga ku rezultojn se aktualisht ka në gjykim 10318 çështje dhe mesatarja e çështjeve në gjykim për gjyqtar rezultojn të jetë 166 dhe pavarësisht ngarkesës ka mjaftueshëm gjyqtarë për ofrimin e shërbimit gjyqësor.

Prandaj, bazuar në sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...}.
- Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi opinionin mbi kandidatin që ka aplikuar për t'u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...}.

1. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare

Naureda Llagami

Specialiste

Rosalba Xhabrahimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
- 6. Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Marçela Shehu.

Merr fjalën zonja Marçela Shehu e cila lexon relacionin shpjegues lidhur me kërkesat që ka paraqitur zonja {...}, Këshilltare Ligjore në Gjykatën e Lartë.

Në relacion parashtrohet se zonja {...}, aktualisht Këshilltare Ligjore pranë Kabinetit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i është drejtuar me disa kërkesa Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku më e fundit është ajo e protokolluar e datës 09.03.2020, me objekt: “Kërkesë për shqyrtimin e kërkesave të mia në lidhje me përcaktimin e statusit si këshilltar ligjor në detyrë pranë Gjykatës së Lartë”.

Në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kërkuesja ka pasur ende pozicionin e ndihmësit ligjor pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, ajo ka plotësuar detyrimet ligjore që impononte ligji nr. 84/2016.

Deri në këtë moment, kërkuesja rezulton t'i jetë nënshtruar testimit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës për efekt të procesit të rivlerësimit pa e kaluar pragun prej 60 % të pikëve dhe nuk ka vijuar karrierën e magjistratit.

Rezulton se nga data 01.01.2019, kohë në të cilën kanë hyrë në fuqi pagat e reja të sistemit të drejtësisë e deri më tani, Gjykata e Lartë ka aplikuar një trajtim financiar të ndryshëm për Këshilltarët Ligjorë në Kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nga të gjithë këshilltarët e tjerë jomagjistratë të kësaj gjykate, duke aplikuar vetëm për këta të fundit, trajtimin financiar që parashikon neni 34, pika 5 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, prandaj dhe zonja {...} kërkon që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë lidhur me statusin e subjektit ex officio të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 179/b/4 të Kushtetutës, parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 84/4 dhe 88/3 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, statusin e nëpunësit civil gjyqësor të Gjykatës së Lartë si dhe të shprehet lidhur me trajtimin financiar të znj. {...} me detyrën e Këshilltarit Ligjor në kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, sipas parashikimeve të nenit 34, pika 5 të ligjit nr.96/2016.

Në kuadër të shqyrtimit të kërkesave të parashtruara nga kërkuesja {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë e cila ndër të tjera është shprehur se: “...Znj. {...} e cila aktualisht ushtron detyrën e Këshilltares Ligjore në kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë sipas përcaktimeve të urdhrin nr. 234, datë 15.09.2017 “Për emërim në detyrë” është subjekt ex officio rivlerësimi dhe gëzon statusin e nëpunësit civil gjyqësor të Gjykatës së Lartë në përputhje me parashikimet e nenit 34, 50, 84 të Ligjit nr. 98/2016. Për këtë arsye edhe trajtimi financiar i saj duhet të kryhet në përputhje me parashikimet e nenit 34, pika 5 të Ligjit nr. 98/2019 duke i filluar efektet financiare që nga data 01.01.2019 kohë në të cilën ka hyrë në fuqi sistemi i ri i pagave për sistemin gjyqësor”.

Më tej zonja Shehu parashtron se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se znj. {...} gëzon statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë në përputhje me parashikimet e nenit 34, 84 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit

gjqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 165 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për shkak se znj. {...} ka filluar marrëdhënien e punës në detyrën e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarit të Gjykatës së Lartë me urdhrin nr. 201, datë 31.10.2014 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Fillimisht marrëdhënia e saj e punës është rregulluar mbi bazën e kontratës individuale të punës me nr. 261 prot., datë 03.11.2014, në nenin 2 të së cilës përcaktohet lidhja e kontratës me afat të përcaktuar, për tre muaj, nga data 03.11.2014 deri në datë 02.02.2015. Më pas marrëdhënia e saj e punës ka vijuar në bazë të kontratës individuale të punës me nr. 24 prot., datë 03.02.2015. Lidhur më kohëzgjatjen e saj në nenin 2 të kontratës përcaktohet se: “Kjo kontratë lidhet me afat kohor të caktuar, prej tre muajsh. Fillon më datë 3 shkurt 2015 dhe përfundon në datën e mbarimit të mandatit të gjyqtares, me të cilën punon si ndihmëse ligjore”.

Kjo marrëdhënie pune, në momentin e fillimit të saj bazohej në parashikimet e ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 20.

Gjatë vijimit të kësaj marrëdhënie pune, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë urdhrin nr.201, 31.07.2017 “Për lirim nga detyra” duke disponuar për lirim nga detyra të znj. {...} me arsyetimin se ka përfunduar afati i kontratës me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë znj. {...}, pranë së cilës ajo ka punuar si ndihmës ligjor. Me urdhrin nr. 234, 15.9.2017, kryetari i Gjykatës së Lartë ka emëruar znj. {...} në detyrën e këshilltares pranë kabinetit të kryetarit të gjykatës, duke përcaktuar në pikën 2 të urdhrin se paga mujore e saj do të përcaktohet sipas parashikimeve të vendimit nr. 187 datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave.

Gjatë kohës që kërkuesja ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarit përkatës (deri në datë 31.7.2017), kanë hyrë në fuqi ndryshimet kushtetuese të miratuara më Ligjin nr. 76/2016 duke parashikuar edhe ndihmësit ligjorë pranë Gjykatës së Lartë si subjekte rivlerësimi ex officio. Konkretisht në nenin 179/b pika 4 parashikohet se: “Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë të gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, do të rivlerësohen ex officio.”

Znj. {...}, në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, ka marrë cilësinë e subjektit të rivlerësimit dhe siç rezulton nga parashtrimi i faktit dhe informacioni i dërguar nga Gjykata e Lartë, ka plotësuar detyrimet ligjore për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratave përkatëse për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar.

Pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese, kanë hyrë në fuqi dhe ndryshimet ligjore respektive që rregullojnë statusin e gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë si dhe organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor në tërësinë e tij. Konkretisht, në kuadër të reformës në drejtësi është miratuar Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Kompetenca e kryetarit të Gjykatës së Lartë për emërimin dhe shkarkimin e ndihmësve ligjorë parashikohej në nenin 7 shkronja “ç”, e cila me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 98/2016 është shfuqizuar dhe nuk mund të ushtrohej më prej tij, duke qenë tashmë, në referim të kuadrit të ri ligjor, një kompetencë ekskluzive e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me ndihmësit ligjorë në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në dispozitat kalimtare, neni 84 pika 4 i Ligjit nr. 98/2016 parashikon se: “4. Ndihmësi ligjor magjistrat dhe këshilltari/ndihmësi ligjor jomagjistrat janë subjekt i dispozitave kalimtare të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve””.

Në referim të këtij parashikimi, statusi ligjor dhe vijimësia e detyrës për ndihmësit ligjorë që kanë qenë në detyrë pranë Gjykatës së Lartë në kohën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 98/2016, përcaktohet nga ligji nr. 96/2016. Në nenin 165 të këtij ligji parashikohet se ndihmësit ligjorë jo magjistratë pranë Gjykatës së Lartë, të cilët sipas kësaj dispozite emërtohen “Këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë” janë subjekte rivlerësimi ex officio, në referim të nenit 179/b/4 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe njëkohësisht, janë subjekte të Ligjit nr. 96/2016, sa i përket statusit të tyre, fillimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës, për sa kohë nuk rezulton të jetë vërtetuar ndonjë shkak ligjor për përfundimin e kësaj marrëdhënie.

Ndihmësit ligjorë në detyrë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë,

vijojnë të qëndrojnë në të njëjtën detyrë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Statusin dhe vijojnë të qëndrojnë po në të njëjtën detyrë, nëse kalojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, nëse nuk kanë zgjedhur të vijojnë karrierën e magjistratit duke ndjekur programin e formimit pranë Shkollës së Magjistraturës sipas nenit 165 pika 4, 5 dhe 6 të ligjit për Statusin.

Pavarësisht faktit se pas hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor si më sipër, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë urdhrin nr. 234 datë 15.9.2017 me të cilin znj. {...} është emëruar Këshilltare Ligjore në Kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ky akt nuk ka cenuar statusin e saj të këshilltarit ligjor në detyrë pranë Gjykatës së Lartë në kuptim të nenit 2 shkronja “d” të Ligjit nr. 98/2016, për këto arsye:

Së pari, rezulton nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Lartë se znj. {...} ka vijuar të ushtrojë të njëjtën detyrë që ushtronte me parë në cilësinë e ndihmësit ligjor, duke ushtruar, ndër të tjera, funksionet e parashikuara në ligjin nr.98/2016, neni 34 pika 2, në të cilin parashikohen funksionet e Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë kësaj gjykate, në të cilën bëjnë pjesë këshilltarët ligjorë.

Së dyti, në kohën e nxjerrjes së urdhrit nr. 234, 15.09.2017, kryetari i Gjykatës së Lartë nuk ka pasur kompetenca ligjore për emërimin/shkarkimin e këshilltarëve ligjorë pasi ndërkohë kishte hyrë në fuqi ligji nr. 98/2016 ku në nenin 34 pika 5 parashikohet se: “5. Këshilltarët ligjorë jomagjistratë emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj”. Në referim të këtij parashikimi ligjor, nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit nr.98/2016, emërimi i këshilltarëve ligjorë jomagjistratë në Gjykatën e Lartë është kompetencë ekskluzive e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së treti, kompetenca e kryetarit të Gjykatës së Lartë për emërimin ose shkarkimin e ndihmësve ligjorë/këshilltarëve ligjorë e parashikuar në nenin 7 shkronja “ç” të Ligjit nr. Nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, në datën e nxjerrjes së këtij urdhri nuk ka qenë në fuqi pasi ishte shfuqizuar prej datës 22.11.2016, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.98/2016. Për pasojë akti i lirimit nga detyra me nr. 201, datë 31.7.2017 dhe akti i emërimit në detyrë nr. 234 datë 15.9.2017 janë akte të nxjerra jashtë kompetencave të kryetarit të gjykatës parashikuar në nenin 37 të ligjit nr.98/2016 dhe për pasojë, në referim të nenit 108

shkronja “a” pika “i” dhe nenit 110 pika 1 të K.Pr.A janë akte absolutisht të pavlefshme dhe nuk mund të prodhojnë pasoja ligjore. Për pasojë akti i lirimit dhe më pas akti i emërimit në detyrën e “Këshilltarit ligjor në Kabinetin e Kryetarit” të znj. {...} nuk ka sjellë asnjë pasojë mbi statusin e saj ligjor si ndihmëse ligjore dhe më pas këshilltare ligjore në detyrë në Gjykatën e Lartë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 98/2016 dhe Ligjit nr.96/2016.

Së katërti, emërimi i znj. {...} në cilësinë e këshilltarit ligjor në kabinetin e kryetarit dhe moskrijimi i “Njësisë së Shërbimit Ligjor” pranë kësaj gjykate, nuk cenon statusin ligjor të saj si këshilltare ligjore në detyrë në Gjykatën e Lartë për arsye se struktura e Gjykatës së Lartë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.98/2016 përcaktohet tërësisht nga ligji dhe mungesa e një akti të brendshëm për përshtatjen e strukturës sipas parashikimeve të ligjit nuk mund të sjellë pasoja mbi vazhdimësinë e statusit ligjor të këshilltarëve ligjorë të Gjykatës të cilët kanë vijuar detyrën pranë kësaj gjykate.

Së pesti, ligji nr.98/2016 nuk e ka lidhur statusin ligjor të ndihmësve ligjore në detyrë të Gjykatës së Lartë me ndonjë akt konfirmimi apo emërimi të ri duke qenë se këto subjekte janë klasifikuar si subjekt rivlerësimi ex officio, në zbatim të nenit 179/b pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ky parashikim garanton vijimësinë e ushtrimit të detyrës së tyre, edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit, nëse nuk vërtetohet ndonjë shkak për mbarimin e funksionit sipas ligjit ose për shkak të procesit të rivlerësimit.

Së gjashti, në nenin 84, pika 1 dhe 4 të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në dispozita kalimtare dhe të fundit (Kreu VI), i titulluar “Statusi i nëpunësit civil në detyrë në Gjykatën e Lartë” parashikohet shprehimisht se: “1.Brenda afatit 6-mujor nga krijimi i Këshillit të Gjykatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson plotësimin e kriterëve formale të punonjësve në detyrë për pozicionin që kryejnë, sipas këtij ligji, me përjashtim të kancelarëve dhe ndihmësve ligjorë...4. Ndihmësi ligjor magjistrat dhe këshilltari/ndihmësi ligjor jomagjistrat janë subjekt i dispozitave kalimtare të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Referuar sa më sipër, rezulton se kërkuesja znj. {...}, në referim të nenit 179/b pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3 pika 16 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, ka marrë ex officio cilësinë e subjektit të rivlerësimit për shkak të qenies në detyrë si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe Ligjit nr. 84/2016, në nenin 4 pika 3 të të cilit parashikohet se: “3. Procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji”. Duke qenë se cilësia e subjektit si subjekt rivlerësimi përcaktohet për shkak të funksionit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore si më sipër ajo nuk mund të përcaktohet apo konfirmohet nga ndonjë organ tjetër. Cilësinë si subjekt rivlerësimi kërkuesja, për shkak të detyrës si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, e ka marrë për shkak të ligjit.

Bazuar në analizën ligjore të parashtruar në relacion, znj. {...} do të vijojë të qëndrojë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të ligjit 96/2016, pra duke ushtruar të njëjtat detyra dhe funksione në përputhje me ligjin e kohës kur znj. {...} ka filluar punën pranë Gjykatës së Lartë, në kushtet kur nuk rezultojnë që marrëdhëniet e saj e punës të ketë përfunduar për ndonjë shkak ligjor apo si rezultat i procesit të rivlerësimit.

Referuar arsytimit si më sipër, znj. {...}, me detyrë Këshilltare Ligjore pranë Gjykatës së Lartë, gëzon statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë në përputhje me parashikimet e nenit 34, 50 dhe 84 të ligjit nr. 98/2016 dhe nenit 165 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për rrjedhojë, edhe trajtimi financiar i saj duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e nenit 34, pika 5 të ligjit nr. 98/2019.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të deklarojë pasjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në detyrë në Gjykatën e Lartë, të znj. {...}”.

Gjithashtu zonja Shehu thekson se përcaktimi këshilltar ligjor në detyrë është për faktin se zonja {...} do të vijojë të qëndrojë përkohësisht në këtë detyrë derisa të ketë një vendim përfundimtar nga organet e vettingut, lidhur me procesin e rivlerësimit si subjekt ex officio rivlerësimi.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Merr fjalën *zonja Brikena Ukperaj* e cila shprehet se nisur nga faktet e pasqyruara në relacion, por edhe nga aktet e dosjes së zonjës {...}, rezulton që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit për Statusin dhe ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor, ajo ka qenë ndihmëse ligjore pranë një gjyqtari të Gjykatës së Lartë. Atëherë, marrëdhëniet e punës së saj rregulloheshin nga një kontratë pune me afat të caktuar sepse pavarësisht se ligji i kohës nuk parashikonte kohëzgjatje të kontratës së punës së ndihmësve ligjorë, ka pasur një vendim të Kolegjeve të Bashkuara që e trajtonte statusin e ndihmësit ligjor mbi të cilin të gjitha kontratat e punës në Gjykatën e Lartë për ndihmësit ligjorë vazhdonin të prodhonin efekte për aq sa kohë zgjaste mandati i gjyqtarit pranë të cilit ndihmësi ligjor punësohej. Pra edhe kur është punësuar në detyrë zonja {...}, është punësuar si ndihmëse ligjore pranë një gjyqtari të caktuar. Në momentin kur zonja {...} është liruar nga detyra me urdhër të kryetarit, urdhër i bazuar në nenin 165/2 të ligjit për Statusin, sipas të cilit këshilltarët ligjorë që ishin në detyrë në Gjykatën e Lartë, vazhdonin të ushtronin detyrën sipas legjislacionit të mëparshëm në përputhje me parashikimet e këtij legjislacioni. Ky legjislacion i mëparshëm, marrëdhënien e punës e rregullonte në bazë të një kontrate pune me afat të caktuar (afati ishte 9-vjeçar nëse do të punësohej, por ajo është punësuar vetëm për 2 vjet e disa muaj, për a kohë i mbaronte mandati zonjës {...}). Urdhri i kryetarit të gjykatës për lirim nga detyra, sipas zonjës Ukperaj, nuk është akt administrativ dhe as veprim administrativ i kryetarit të gjykatës sepse ka një vendim unifikues i cili thotë që urdhrat e kryetarit të gjykatës të cilat merren në kuadër të një marrëdhënieje pune, jo vetëm të kryetarit, por të çdo titullari të administratës publike, nuk janë akte administrative, por janë thjesht urdhra të punëdhënësit që trajtohen në kuadër të mbarimit të kontratës së punës. Për sa kohë ky urdhri i kryetarit, i cili thjesht i thotë zonjës {...} të dorëzojë detyrën sepse mandati i gjyqtarit ka mbaruar dhe po kështu edhe efektet e kontratës së saj, nuk është akt administrativ dhe as veprim administrativ, prandaj nuk mund të shqyrtohet vlefshmëria e tij.

Më tej zonja Ukperaj shton se zonja {...} ka mbaruar së ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në datën 15.09.2017 sepse në atë moment i kanë mbaruar edhe efektet

financiare, pavarësisht se urdhri i lirimit nga detyra ishte në korrik 2017. Në të njëjtën ditë, kryetari i gjykatës e emëron si këshilltare në kabinetin e tij. Këshilltari i Kabinetit nuk është këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë. Statusi i këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë është i ndryshëm nga statusi i këshilltarit të kabinetit pasi ata emërohen sipas një legjislacioni tjetër, siç janë edhe në Këshill këshilltarët në Kabinetin e Kryetares.

Këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë janë ndihmësit ligjorë të cilët kanë një status tjetër të ndryshëm, për shembull, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, këshilltarët e kryetarit nuk janë bërë subjekt “ex officio” të vettingut, pra ata nuk janë këshilltarë ligjorë. Me vullnet zonja {...} ka vazhduar të kryejë detyrën e këshilltarit të kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili nuk është këshilltar ligjor dhe nuk rezulton që të ketë kryer detyrën e ndihmësit ligjor sepse që nga ai moment e deri më sot nuk ka bërë asnjë relacion si ndihmëse ligjore, por thjesht ka asistuar/këshilluar kryetarin e Gjykatës së Lartë në marrëdhëniet institucionale që ka Gjykata e Lartë. Këtë status, zonja {...} e ka edhe sot (këshilltare e kabinetit).

Më tej zonja Ukperaj shton se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit të rivlerësimit, zonja {...} kishte statusin e ndihmësit ligjor dhe për këtë shkak është bërë subjekt i “ex officio” i rivlerësimit kalimtar, por ky fakt nuk është i mjaftueshëm për të thënë që sa kohë ajo është subjekt rivlerësimi, ka edhe statusin e këshilltarit ligjor. Sipas nenit 165/2 e ligjit për Statusin, dispozita që rregullon statusin e këshilltarëve në detyrë në Gjykatën e Lartë (citohet neni), pra marrëdhënia e punës së këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, në ndryshim nga këshilltari në Gjykatën Kushtetuese dhe ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Apelit, ka pasur afat të caktuar brenda të cilit duhet të përfundonte. Si zonja {...} janë edhe 10 ose më shumë ndihmës të tjerë që në të njëjtin moment që u ka mbaruar mandati gjyqtarëve, kanë dorëzuar punën, kanë marrë urdhrin e lirimit, madje edhe janë punësuar në vende të tjera.

Urdhri i emërimit në detyrë në shtator 2017 është një marrëdhënie e re juridike pune midis kryetarit të gjykatës dhe një ish-ndihmëse ligjore dhe jo kalim nga një pozicion në një tjetër.

A është e vlefshme kjo? –Në vlerësimin e saj, zonja Ukperaj vlerëson se kjo është e vlefshme sepse në atë kohë kryetari i gjykatës kishte të gjithë kompetencat dhe tagrin

për të vendosur lidhur me çështjet e organikës dhe të strukturës së gjykatës sepse këto të drejta iu shfuqizuar katër muaj më pas se të krijohej Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në këtë kuadër ai kishte edhe të drejtë të rekrutonte Këshilltarë në kabinetin e tij. Vazhdimi i punës si këshilltar në kabinet, nuk do të thotë që i ka ridhënë statusin e këshilltarit ligjor zonjës {...}. Ajo e ka bërë me vullnet të lirë dhe në momentin që është krijuar KLGJ ka paraqitur kërkesën për të fituar tashmë statusin ose për ta konfirmuar si të pandërprerë statusin e ndihmësit ligjor.

Në përfundim, zonja Ukperaj, pasi analizon çështjen në fjalë, vlerëson se zonja {...} nuk kryen detyrën e ndihmësit ligjor, por kryen detyrën e këshilltarit pranë kabinetit të kryetarit. Gjithashtu, kontrata e punës me Gjykatën e Lartë ka përfunduar në 15 nëntor 2017 sikundër ka përfunduar edhe i të gjithë ndihmësve të tjerë dhe punësimi pranë kabinetit të kryetarit të Gjykatës së Lartë është një marrëdhënie e re. Prandaj, zonja Ukperaj vlerëson që zonja {...} nuk gëzon statusin e këshilltarit ligjor.

Lidhur me vijimin e procesit të rivlerësimit, zonja Ukperaj vlerëson që zonja {...} është larguar nga puna dhe nuk vihet në diskutim zbatimi i nenit 165/9 e ligjit për Statusin. Gjithashtu vlerëson se shqyrtimi i mëtejshëm i vlefshmërisë së largimit, i emërimit në kabinetin e kryetarit, janë çështje të juridiksionit gjyqësor që do të krijojnë precedent në vendimmarrjet e Këshillit dhe vendimi i zonjës {...} do të interferojë në vijueshmërinë e marrëdhënieve të punës që kanë pasur edhe këshilltarët e tjerë që janë larguar nga Gjykata e Lartë dhe vijojnë edhe sot të jenë akoma subjekte rivlerësimi. Pasja e statusit si subjekt rivlerësimi nuk sjellë pasjen e statusin e këshilltarit ligjor, prandaj zonja {...} nuk e ka statusin e këshilltarit ligjor, sipas zonjës Ukperaj.

Më tej merr fjalën *zoti Erjon Muharremaj* i cili vjen me një pyetje drejtuar Komisionit: A e konsideron Komisioni i Zhvillimit të Karrierës akt administrativ urdhrin nr. 234, datë 15.09.2017 “Për emërimin në detyrë të zonjës {...}”, të kryetarit të Gjykatës së Lartë?

Duke qenë se *zonja Shehu* mendon se qëndrimi i Komisionit është parashtruar i gjithi në relacionin shpjegues, i cili është shumë i detajuar, ndaj për këtë shkak nuk beson

se ka nevojë për një përgjigje, atëherë, **zoti Muharremaj** rimerr fjalën për t'u shprehur se urdhrin “Për emërimin në detyrë”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e konsideron këtë si një akt administrativ.

Referuar nenit 110/2 të K.Pr.A., pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë të çdo të interesuari, së pari nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente. Në vlerësimin e tij, zoti Muharremaj vlerëson që nuk futet Këshilli në asnjë nga këto katër kategori, prandaj nuk pajtohet me qëndrimin e Komisionit që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kompetencën për të konstatuar pavlefshmërinë absolute të urdhrin të kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Me tej merr fjalën **zonja Brunilda Kadi** e cila së pari mendon se si pasojë juridike, si quhet akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, si konsiderohet në formën që e diskutoi zonja Ukperaj, në fund të diskutimit, rezultati është i njëjtë, duke mos kuptuar as qëllimin e pyetjes që bëri zoti Muharremaj, pasi edhe për konstatimin e bërë në fund nga ai, zonja Kadi nuk është dakord, pasi Këshilli është organi që e zbaton dhe Gjykata e Lartë është nën juridiksionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Zoti Ilir Toska merr fjalën për t'iu përgjigjur zotit Muharremaj dhe zonjës Ukperaj lidhur me urdhrin e kryetarit të Gjykatës së Lartë (nëse është apo jo një akt administrativ sa i përket marrëdhënies së punës së këshilltarëve ligjorë jomagjistratë në Gjykatën e Lartë), duke sjellë në vëmendje se me hyrjen në fuqi të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” ku rregullohet edhe statusi për këshilltarët dhe ndihmës magjistratët në Gjykatën e Lartë, organi i emërtesës për këshilltarët ligjorë jomagjistratë është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe në këtë kuptim, organi i emërtesës edhe për këshilltarët ligjorë në detyrë është Këshilli i Lartë Gjyqësorë i cili duhet të ndjekë edhe procedurat sa i përket karrierës apo përgjegjësiive disiplinore për to. Ligji ka konsideruar një status të veçantë për këshilltarët ligjorë jomagjistratë dhe ka ngarkuar Këshillin e Lartë Gjyqësor të dalë me akte individuale, të cilat janë të ankimeshme në gjykatë referuar ligjit “Për pushtetin

gjqësor”.

Pas diskutimeve lidhur me çështjen, hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, të znj. {...}”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është kundër.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është kundër, me arsyetimin e bërë më lart tek diskutimet.

Brikena Ukperaj është kundër, me arsyetimin e bërë më lart tek diskutimet.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

(3 vota kundër dhe 8 vota pro. Me shumicën e votave miratohet propozimi i ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.)

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: 1. Të deklarojë pasjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat, në Gjykatën e Lartë, të znj. {...}.

2.Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
- 6. Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

9. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili njofton për një problem në serverin qendror i cili nuk është mundur të rregullohet nga punonjësit e IT-së dhe për këtë arsye propozon që kjo pikë të shqyrtohet ditën e hënë ose të procedohet me short manual.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit shtyrja e kësaj pike të rendit të ditës, për t’u shqyrtuar ditën e hënë, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Hedhja e shortit shtyhet për t'u zhvilluar ditën e hënë.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.05.2020)

Pika 10 shtesë e rendit të ditës me objekt: Diskutim në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të mbledhjeve plenare për sa i përket mënyrës se si zhvillohen ato në kushtet e pandemisë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
- 6. Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

10 shtesë. Diskutim në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të mbledhjeve plenare për sa i përket mënyrës se si zhvillohen ato në kushtet e pandemisë.

Merr fjalën *zonja Kadi* e cila është e mendimit se Këshilli duhet të vendosë se si të vijojë me mënyrën e zhvillimit të mbledhjeve plenare sepse mënyra më e mirë është që të shkohet në normalitet. Zonja Kadi mendon se ka disa fakte mbi të cilat referohet dhe mendon se mbledhjet mund të bëhen në sallën e mbledhjeve plenare, por për të qenë edhe në përputhje me ato çka thotë akti normativ, zonja Kadi propozon që organet kompetente, pasi të verifikojnë situatën, të japin një opinion zyrtar nëse Këshilli, në dosmosdoshmëritë që ka për të qenë prezent një numër i caktuar në atë sallë, ka apo s’ka mundësi sipas protokolleve mjekësore të zhvillojë mbledhjen në sallën plenare.

Zonja Kadi është e mendimit që mbledhja mund të realizohet në sallën e mbledhjeve plenare, duke iu referuar dy fakteve: i. Ka disa seanca të mbledhjeve plenare që Kuvendi i Shqipërisë i zhvillon fizikisht me deputetët prezent dhe ato distanca dhe ato protokolle që mund të jenë zbatuar aty, pra ato kushte i plotëson edhe salla plenare e Këshillit; ii. Fakti tjetër që i referohet zonja Kadi është zhvillimi i një mbledhjeje në Gjykatën e Lartë, ku nga fotografia duken që kanë marrë pjesë minimumi 10 persona. Ndërkohë që Këshilli, të paktën për disa çështje që janë urgjent për t’u diskutuar në

sallën e mbledhjeve dhe ku mund të marrin pjesë vetëm 12 persona (11 anëtarët dhe zonja që merret me procesverbalin), zonja Kadi është e mendimit që salla e mbledhjeve plenare të Këshillit i plotëson të gjitha kriteret, sipas protokolleve mjekësore.

Ndaj zonja Kadi e sjell si diskutim çështjen, pasi është përgjegjësi e Këshillit që të vendosë dhe ajo që propozon është që t'i kërkohet në mënyrë urgjente organeve kompetente që të përpilojë një dokument ose kërkon të vihet në dispozicion dokumenti, nëse ka një të tillë, nga Kryetarja, se ku është bazuar që vendosi që në mbledhjen plenare mund të rrinë vetëm 5-6 persona dhe jo 2 ose 3 ose më shumë persona. Nëse nuk është ky dokument, atëherë t'i kërkohet në mënyrë urgjente organit kompetent që të përpilojë një dokument të tillë.

Zonja Llagami sjell në vëmendje që Këshilli ka miratuar një rregullore mbi bazën e protokolleve që Ministria e Shëndetësisë kishte miratuar, rregullore e miratuar në mënyrë unanime në Këshill. Gjithashtu sjellë në vëmendje se ka një sërë aktesh të tjera ligjore të cilat krijojnë mundësi që secili prej nesh duhet të punojë në mënyrë të distancuar 2m dhe ka edhe disa kriteret për mënyrën se si operohet në sallat e mbyllura ku mungon sistemi i ajrimit dhe që janë pa ventilim.

Sa i përket faktit që nuk është vënë në dispozicion dokumentacioni nga ana e Kryetares, zonja Llagami shprehet se në asnjë moment nuk është komunikuar dhe kërkuar baza ligjore. Është miratuar, si institucion i pavarur, rregullorja, duke mbajtur parasysh të gjithë protokollet dhe mënyrën e Këshillit për të vepruar, duke punuar me ditë, ku stafi gjithashtu nuk vjen çdo ditë në punë, duke respektuar distancat. Është ngritur edhe struktura përkatëse që ka vlerësuar situatën brenda sallave dhe mungesën e ajrimit për pamundësinë e zhvillimit të mbledhjeve të gjithë së bashku.

Zonja Llagami është dakord me propozimin e sjellë për këtë qëllim dhe nëse Këshilli kërkon të ndryshojë mënyrën se si operon, është e hapur të diskutohet, që të jetë Këshilli që të vendosë, që edhe përgjegjësia të mos jetë e titullarit të institucionit.

Pas sqarimit dhe fjalës së zonjës Llagami, merr fjalën *zoti Muharremaj* për të bërë një pyetje në lidhje me marrjen e informacionit mbi stadin që ndodhet përgatitja për

sallën e re të mbledhjeve plenare në godinën Poli i Drejtësisë.

Sa i përket situatës në lidhje me godinën e re, **zonja Llagami** sqaron se qeveria ka zbardhur vendimin në zbatim të të cilit Ndërmarrja nr. 1 e Ministrisë së Financave do merret me të gjithë menaxhimin e ndërtesës. Më pas, ndërtesa nga kjo Ndërmarrje do t'i kalojë Këshillit përmes një kontrate huapërdorjeje. Me pak fjalë, zonja Llagami shprehet se Këshilli nuk është ende gati të shkojë në godinën e re.

Ndërsa lidhur me sallën e mbledhjeve plenare në godinën Poli i Drejtësisë, zonja Llagami sqaron se për të zhvilluar mbledhje plenare atje duhet që të jetë i përfunduar sistemi audio si dhe për të zhvilluar mbledhje në mënyrë të ligjshme në godinën e re, duhet që Këshilli të ketë marrë në dorëzim këtë godinë dhe më pas të bëhet klasifikimi i zonave të veprimtarisë në këtë ndërtesë. Edhe lidhur me procedurën e prokurimit të sistemit audio që është parashikuar për atë ndërtesë, për shkak të situatës së pandemisë, kjo procedurë është e pezulluar, kështu që ka vështirësi për të operuar në atë ndërtesë, qoftë edhe në mënyrë të përkohshme.

Rimerr fjalën **zonja Kadi** e cila shprehet se me e-mailin e datës 15 prill është kërkuar se “mbi çfarë protokollit mjekësor jeni referuar juve që është dalë në konkluzionin që në këtë sallë rrinë 5 ose 6 persona”, që të dinin edhe anëtarët e të dilnin në një konkluzion edhe anëtarët, dhe i drejtohet zonjës Llagami duke u shprehur se Këshilli është një organ kolegjal dhe vendimet janë kolegjiale, nuk merren nga Kryetari, dhe kjo nuk ka të bëjë me bazën ligjore, por me dokumentin ku është bazuar fakti që në sallë rrinë 5-6 persona, pasi është e ndryshme dokumenti nga baza ligjore.

Rregullorja që referohet më sipër është bazë ligjore, por nuk është kërkuar nga njeri, pasi siç edhe dihet, edhe zonja Kadi bën pjesë në draftimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje por nuk është kërkuar baza ligjore dhe pikërisht në bazë të kësaj rregulloreje, zonja Kadi pyet se si është konkluduar që nuk bëhen mbledhjet në atë sallë sepse cenohet rregullorja. Si është dalë në këtë konkluzion? -pyet zonja Kadi.

Zonja Kadi i referohet fjalës së zonjës Llagami mbi ngritjen e një grupi pune që ka bërë këto inspektime dhe që ka dalë në konkluzionin që aty nuk bëhen mbledhje.

Pikërisht, zonja Kadi kërkon të ketë në dispozicion këtë dokument të nënshkruar nga grupi i punës.

Zonja Kadi mendon që duhet të ketë një organ kompetent që të certifikojë zbatimin e protokolleve mjekësore dhe të rregullores që është miratuar nga Këshilli. Pra rithekson zonja Kadi që nuk bëhet fjalë për referencë në bazë ligjore, por bëhet fjalë për zbatimin e referencës ligjore në rastin e sallës së mbledhjeve plenare.

Në vijim merr fjalën *zonja Ukperaj* e cila i referohet masave që Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë në faqen e saj të internetit dhe një nga masat e Ministrisë së Shëndetësisë është që nuk lejohen grumbullimet në ambiente publike të mbyllura të më shumë se 5 personave.

Zonja Ukperaj propozon që Këshilli t'i drejtohet Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor të vijë të shikojë sallën e mbledhjes dhe të japë mendimin e tyre nëse kjo sallë garanton zhvillimin e mbledhjes plenare në këto kushte.

Nisur nga diskutimi i bërë nga zonja Ukperaj dhe nga diskutimi i ngritur në seancë dhe nëpërmjet e-mailit, *zonja Kadi* kërkon që të marrë një përgjigje lidhur me pyetjen e saj. Ndërsa, lidhur me atë çka diskutoi zonja Ukperaj, i bie që deputetët e Kuvendit të Shqipërisë kanë shkelur aktin normativ, -shton zonja Kadi, pasi salla e Kuvendit është një sallë e mbyllur. Gjithashtu, edhe salla e Gjykatës së Lartë ku zonja Llagami ka marrë pjesë, në prezencën e të paktën 10 personave, i bie që kanë shkelur aktin normativ.

Lidhur me diskutimet e bëra nga zonja Kadi, *zoti Toska* është i mendimit që diskutimet duhet të bëhen bazuar në aktet që Këshilli ka detyrim t'i respektojë dhe nuk mund të konsiderohen vlerësimet subjektive krahasuese që zonja Kadi përpiqet të bëjë. S'ka pse të konsiderojë një situatë të caktuar në një godinë tjetër që lidhet me situatën me godinën e Këshillit, nëse atje janë respektuar apo jo protokollat shëndetësore.

Zoti Toska mbështet propozimin e zonjës Ukperaj, që të merret mendimi i autoritetit shëndetësor që ka ngarkuar ligji dhe të vijohet nëse mund të zhvillohen

mbledhjet fizikisht duke respektuar masat e vendosura për pandeminë apo nuk mund të zhvillohen.

Edhe **zonja Kadi** ka të njëjtin propozim, duke propozuar që kërkesa drejtuar këtij autoriteti për bërjen e këtij verifikimi të jetë me urgjencë, pasi janë shumë çështje të cilat duhet të zhvillohen në sallën e mbledhjeve plenare. Zonja Kadi insiston që duhet bërë me urgjencë kërkesa tek ky autoritet dhe ky verifikim nga ky autoritet.

Në mbështetje të propozimeve më lart, edhe **zonja Shehu** është e mendimit që duhet të kërkohet me urgjencë mendim i specializuar me qëllim dhënien e një opinioni nga ekspertët, në mënyrë që Këshilli mos të bëhet shkak për vonesa të proceseve të rëndësishme me të cilat përballet sot Këshilli.

Gjithashtu edhe **zoti Toro** bashkohet me propozuesin (znj. Kadi) dhe me zonjën Ukperaj, në kushtet kur akti normativ i marsit, në nenin 5 bën fjalë pikërisht për vendimmarrjen e organeve kolegjiale dhe lejon mundësinë që jo vetëm të bëhen fizikisht por mund të realizohen edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Kështu që verifikimi nga ana e Inspektoratit Shëndetësor nëse plotësohen kushtet apo jo, do të ishte i dobishëm për të realizuar mbledhjen fizikisht në sallën e mbledhjeve plenare.

Gjithashtu zoti Toro shprehet mbi vështirësitë që ka realizimi i mbledhjes plenare nëpërmjet platformës online dhe i referohet mbledhjes aktuale e cila për të pjesa më e madhe ka shkuar kot, pasi nuk ka pasur mundësi të dëgjojë diskutimet nga ana e kolegëve për shkak të internetit që nuk e ka mundësuar sigurinë e komunikimit elektronik.

Në përfundim të diskutimeve, anëtarët e Këshillit bien dakord mbi propozimin lidhur me kërkesën drejtuar organit të specializuar për të dhënë një qëndrim lidhur me mundësinë nga ana e Këshillit për të zhvilluar mbledhjet plenare në sallën e Këshillit, duke vlerësuar edhe kushtet e ambientit të sallës.

* * *

(Pika 10 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor